



Stadt Bielefeld

Ideen für den Schulstart

Albanisch

www.bielefeld.de

Idetë për fillimin
e shkollës



Dëftues botimi

Botuar nga:



Kommunales
Integrationszentrum
Bielefeld



Stadt Bielefeld
Amt für Jugend und Familie
- Jugendamt -

Përgjegjës për përbajtjen:

Nilgün Isfendiyar, Leiterin des Kommunalen Integrationszentrums
Georg Epp, Leiter des Amtes für Jugend und Familie - Jugendamt -

Redaksioni:

Karolina Dombek, Christoph Hein, Birgit May, Monika Schelp-Eckhardt

Dizajni:

Stadt Bielefeld, Zentrale Leistungen, Druckservice

Mbështetur nga:

Ministerium für Kinder, Familie,
Flüchtlinge und Integration
des Landes Nordrhein-Westfalen



Ministerium für
Schule und Bildung
des Landes Nordrhein-Westfalen



Diese Broschüre ist in einfacher Sprache verfasst.

Verfügbar auch in den Sprachen:

Albanisch, Arabisch, Bulgarisch, Englisch, Griechisch, Kurdisch (Kurmanci, in lateinischer Schrift), Polnisch, Russisch, Serbisch, Türkisch

Versioni digjital (pdf) nën:

www.ki-bielefeld.de und www.bielefeld.de/de/biju/sp/

Gjendja: 07/2019





Përbajtje

1. Parathënia	1
2. Të jesh në lëvizje – themeli i të mësuarit	2
3. Ti ushtrosh duart	4
4. Të pamvarsohesh	6
5. Të jesh me fëmijët e tjerë	8
6. Të hani dhe pini shëndetshëm	10
7. Të Lexosh me zë, të tregosh dhe të luash me gjuhën	12
8. Të flasësh disa gjuhë	14
9. Të bësh muzikë, të luash me tingujtë	16
10. Zbulimi i matematikës në jetën e përditshme	18
11. Eksperimentimi dhe befasimi	20
12. Eksplorimi dhe mbrojtja e natyrës	22
13. Trajtimi i mjeteve të komunikimit	24

1. Parathënie libri

Të dashur prindër dhe kujdestarë,
fëmija i juaj së shpejti do të jetë në shkollë.

Qendra e kujdesit ditor tashmë po përgatit fëmijën tuaj për në shkollë: Fëmija i juaj po mëson me fëmijët e tjerë. Ai është duke rregulluar dhe ndërtuar. Është duke u përpjekur me vetvehtën dhe botën jashtë. Është duke lëvizur shumë dhe me këtë është duke e forcuar trupin e tij. Ai shikon librat dhe tregon se çfarë sheh në to. Dëgjon tregime dhe u përgjigjet pyetjeve. E gjithë kjo ndihmon fëmijën tuaj më vonë përgjat mësimit në shkollë.

Edhe ju mundeni ta përgatisni fëmijën tuaj për në shkollë. Lidhur me këtë do të gjeni ide të ndryshme në këtë fletushkë. Ato ide mundeni pa shumë përpjekje edhe ti zbatoni. Cilat ide do të donit ti provonit me fëmijën tuaj?

I dëshirojë fëmijës suaj një kohë interesante deri në fillimin e vinit shkollorë. Gjithashtu ju dëshirojë juve shumë kënaqësi përgjatë përcjelljes së fëmijës suaj.



Pit Clausen
Kryetari i Bashkisë

2. Të jesh në lëvizje – Themeli i të mësuarit

Lëvizja ndihmon mësimin. Nëse fëmija i juaj lëvizë shumë dhe me dëshirë, atëherë ai mund të mësojnë më mirë. Atëherë edhe lëvizjet e imta përgjat shkrimit do të janë më të suksesshme. Në jetën e përditshme ka shumë mundësi për lëvizje.

Idetë:

- Shkoni me fëmijën tuaj jashtë: në një park, në pyll ose në një shesh lojtrash. Ai atje mund të vrapon, të ngjitet, të luajë me top dhe shumë më tepër.



- Në banesë fëmija juaj mund të luajë me jastëkë, dyshekë dhe gjëra të tjera. Aty mund të hidhet mirë dhe të bëjë gjimnastikë.
- Fëmija juaj duhet të luajë me fëmijët e tjerë sa më shpesh të jetë e mundur.
- Ngasja e bicikletës apo trotinetit është argëtuese. Përgjat kësaj, fëmija praktikon mbajtjen e ekuilibrit të tij.



- Shkoni me fëmijën tuaj në pishinë. Është mirë nëse fëmija juaj ka argëtim në ujë. Në një kurs noti fëmija juaj mund të mësojë të notojë.
- Ju jeni shembulli më i rëndësishëm për fëmijën tuaj, prandaj lëvizni edhe ju sa më shumë!

Besoni në aftësitë e fëmijës suaj. Përmes lëvizjeve, fëmija i juaj kupton se çfarë mund të bëjë dhe se çfarë duhet ende të mësoj.



3. Ti ushtrosh duartë

Per të shkruar dhe ndërtuar- formuar, fëmija juaj ka nevojë për duar të shkathta. Ju mundeni që ti nxisni këto shkathtësi në përditshmëri dhe përgjat lojës.

Idetë:

Në kuzhinë

- Gatuani së bashku me fëmijën tuaj. Fëmija juaj mund të prejë perimet, ta ndrydhë brumin apo edhe të lajë pjatat. Kjo është kënaqësi dhe përmirëson shkathtësitë.

Ndërtim-formimi

- Krijoni me fëmijën tuaj një vend të caktuar për ndërtim-formim. Aty mundet fëmija i juaj të ngjyrosë, të gatuaj apo të prejë letër. Gjithashtu ai mund të ndërtoj-formoj edhe me dru apo gjethë të pyllit.



Loja

- Shumë lojëra nxisin shkathtësitë e gishtërinjve.

Për shembull:

Lojë me bashkim pjesësh, Mikado, blloqe druri, rruaza, udhë me top, Lego®



Kujdesuni që fëmija juaj përgjat pikturimit ta mbanë lapsin ashtu siç duhet.

4. Të pamvarsohesh

A mundet që fëmija juaj të bëjë shumë gjëra vetë? Pastaj fëmija juaj do të ndjehet më i sigurtë në shkollë. Fëmijët e pamvarur mësojnë më mirë dhe janë më të vëtdishëm.

Pra, pyesni veten përsëri dhe përsëri: çfarë mund të bëjë fëmija im vetë? Ku duhet ta ndihmoj?

Idetë:

- Ushtroni veshjen dhe zhveshjen me fëmijën tuaj. Për shembull Të këpucëve, xhaketës dhe veshmbathjes sportive.
- Mendoni së bashku me fëmijën tuaj: Çfarë detyre do të donte fëmija juaj të merrte përsipër në shtëpi? Mund të mbulojë, për shembull, tavolinën. Pasi që e ka përmbushur fëmija juaj detyrën e tij? lëvdojeni atë.
- Fëmija juaj duhet të shkojë vetëm në banjë. Duhet ti lajë duart e tija vetëm.



- Në fillim, paketoni çantën e shkollës bashkë me fëmijën tuaj. Me kalimin e kohës, fëmija juaj mund ta paketojë çantën vetëm.
- Tregoni fëmijës tuaj herët rrugën për në shkollë. Gjithashtu shikoni së bashku edhe rrethinën.



Fillimi i shkollës do të thotë një ndryshim i madh për të gjithë familjen. Ndoshta fëmija juaj është i pasigurt në javët e para. Jini të durueshëm.

Thuani atij shpesh, „Do ta kryesh këtë!“

5. Të jesh me fëmijët e tjerë

Për fillimin e shkollës, është mirë nëse fëmija juaj është bashkë me fëmijët e tjerë. Ata luajnë, hanë dhe piktuojnë. Ata përlahen dhe pajtohen. Ata luajnë dhe pushojnë.

Idetë:

- Sjellni rregullisht fëmijën tuaj në qendrën e kujdesit ditor.
- Ftoni shokët dhe shoqet e fëmijës tuaj për të luajtur. Fëmija juaj duhet të vizitojë edhe fëmijët e tjerë.
- Tregoni fëmijëve lojërat shoqërore. Në keto lojëra, fëmija i juaj mëson të fitojë dhe të humbasë. Gjithashtu mëson t'i përbahet rregullave.



- Sporti, vallëzimi dhe muzika janë shumë zbatitëse në grup. Shumë klube dhe shkolla muzikore kanë shumë oferta për fëmijët.

www.sportjugend-bielefeld.de
www.muku-bielefeld.de

- Merrni pjesë në organizimet familjare.

www.bielefeld.jetzt/termine/kinder
www.bielefeld.de/de/kf



6. Të hani dhe pini shëndetshëm

Ushqimi dhe pijet e shëndetshme janë të rëndësishme. Kështu që fëmija juaj mund të rritet dhe të mësojë mirë.

Disa gjëra ushqimore duhet që fëmija i juaj ti hajë më shpesh. Disa gjëra ushqimore të tjera fëmija juaj duhet ti hajë më rrallë. Qendra shtetërore për edukim shëndetësor bën sugjerime:

Këto gjëra duhet që fëmijët ti hanë dhe të pijnë shumë:

- Frutat, perimet, patatet, pastën, orizin dhe bukën
- Ujin, çajin pa sheqer

Këto gjëra duhet që fëmijët ti hanë dhe pijnë në masë:

- Qumështin, djathin, mishin, sallamën, vezët, peshkun

Këto gjëra duhet që fëmijët ti hanë dhe pijnë pak:

- Gjalpin, vajin, mazën,ëmbëlsirat, ushqimet e kripura te thata

Këto gjëra duhet që fëmijët ti hanë dhe pijnë rrallë:

- Ushqime të shpejta (patate të skuqura, burgerë, pizza, . . .)
- pije të ëmbëla (limonada, lëngje frutash, . . .)



Idetë:

- Merrni kohë për të ngrënë me fëmijën tuaj. Kjo kohë e përbashkët është e rëndësishme për familjen. Pergjat kësajë Fëmija juaj mëson shumë: Si mund ta mbaj thikën dhe pirunin tim? Kur duhet që të filloj të ha? Kur guxoj të ngrihem nga ngrënja?
- Planifikoni së bashku atë që dëshironi të hani. Për shembull, ju mund të sugjeroni dy vakte, e pastaj Fëmija juaj mund të zgjedhë njërin prej tyre.
- Përgatitni ushqimin së bashku me fëmijën tuaj. Pergjat përgaditjes ai mëson shumë për produktet ushqimore. Duke prerë diçka, fëmija juaj gjithashtu mësohet që ti përdorë duartë me një zgjuarësi më të madhe.
- Lëreni fëmijën tuaj të vendosë për veten se sa dëshiron të hajë. Fëmijët dinë të vlerësojnë mirë se kur kan ngrënë mjaft. Besoni ndjenjës së fëmijës suaj.
- Fëmijët mendojnë pozitivisht për ushqimin dhe pijen. Ata pëlqejnë të provojnë. Ofroni fëmijës suaj ushqime të ndryshme.
- Produktet ushqimore për fëmijëve janë shpesh jo të shëndetshme. Kushtojini vëmendje informatave mbi sheqerin dhe yndyrën në paketim.
- Bëhuni një shembull për fëmijën tuaj sa i përket blerjes dhe ngrënjes.



7. Të lexosh me zë, të tregosh dhe të luash me gjuhën

Leximi me zë është i rëndësishëm! Fëmija juaj do të mësojë fjalë dhe fjali të reja. Kjo i ndihmon atijë të mësojë të lexojë dhe të shkruajë. Fëmija juaj mëson shumë për botën përmes librave dhe tregimeve. Prandaj, leximi me zë të lartë dhe tregimi i tregimeve duhet të jetë pjesë e jetës së përditshme për çdo familje.

Idetë:

- Shikoni me fëmijën tuaj librat me fotografi. Bisedoni me të rreth fotografive. Për shembull, pyteni se çfarë sheh në foto?
- Kërkonit fjalë që lidhen me ritëm. P.sh. shtëpija – fëmija.
- Pyetni fëmijën tuaj se cilin libër dëshiron ai që ju të ja lexoni me zë.
- Lexojani emocionalishtë. Ndryshoni zërin tuaj: Ariu mund të flasë me një zë më të thellë dhe më të lartë ndërsa miu me një zë pëshpëritës, e gjarpëri në formë kërcënuese.
- Gjithmonë lexoni në një kohë të caktuar. Për shembull, para se të bini në gjumë. Kënaquni me afërsinë e fëmijës tuaj.





Prindërit që lexojnë janë shembull për fëmijët e tyre!

- Vizitoni bibliotekën me fëmijën tuaj.
- Luani me gjuhën në udhëtime të gjata në veturnë ose në tren. Për shembull, fëmija juaj mund të mbledhë fjalët: Cilat gjallesa jetojnë në ujë? Cilat gjallesa jetojnë me ajër?
- Përshkruani një kafshë dhe fëmija juaj duhet ta gjejë atë. Për shembull: Unë njoh një kafshë që ka një theqkë(hundë) të gjatë. Fëmija i juaj gjithashtu mund të përshkruajë kafshët dhe ju duhet që pastaj ti qëlloni.
- Filloni të tregoni një tregim, pastaj lëreni fëmijën tuaj që ta gjejë se për cilin tregim është fjala, apo lereni atë të vazhdojë me tregimin e tregimit.
- Luani me fëmijën tuaj: „Unë shoh diçka që është e kaltër dhe se ti nuk e sheh. Çfarë është ajo? „Fëmija juaj e kërkon sendin.
- Tregoni jashtë fëmijës suaj shkronjat dhe simbolet. Fëmija juaj mund ti gjejë tabelat e automjeteve, logot apo emrat e ndryshëm.

8. Të flasësh disa gjuhë

Shumë fëmijë në Gjermani rriten duke folur disa gjuhë të ndryshme. Këto gjuhë të ndryshme janë një pasuri e madhe për shoqërinë tonë.

A flisni (shpesh) një gjuhë tjetër përveç gjermanishtes në shtëpi?

Pra nxiteni fëmijën tuaj në gjuhën tuaj familjare!


Sepse: fëmija juaj mund të mësojë gjuhën tuaj familjare dhe gjermanishten.

Është e rëndësishme që fëmija juaj të flasë të dy gjuhët në jetën e përditshme.

Idetë:

- Jujeni shembulli më i rëndësishëm përfëmijën tuaj. Gjithashtu edhe me gjuhën. Flisni shumë me fëmijën tuaj. Sa më shumë fjalë që përdor fëmija juaj, aq më mirë mund të kuptojë botën.
- Mbështetni interesin e fëmijës tuaj në gjuhën e familjes: Tregoni tregime fëmijës suaj. Bisedoni me të rime. Këndoni së bashku këngë nga fëmijëria juaj.
- Librat dhe lojërat që degjohen në gjuhën tuaj mundeni që ti huazoni falas nga biblioteka.

Përgjat regjistrimit në shkollë, pyetni nëse
ka mësim gjuhe në gjuhën tuaj familjare
(Herkunftssprachlicher Unterricht).



9. Të bësh muzikë, të luash me tingutë

Fëmijët e duan muzikën. Ata vallëzojnë sapo të kanë dëgjuar muzikën. Ata provojnë gjithçka që bën zhurëm ose tinguj.

Muzika ndihmon zhvillimin e fëmijës suaj.

Kush këndon, mëson të flasë më lehtë.

Kush vallëzon, mund të lëvizë më mirë.

Muzika është edhe më shumë argëtuese së bashku me fëmijët e tjerë.

Idetë:

- Këndoni me fëmijën tuaj. Ushtroni me të rimimin e këngës për fëmijë.
- A festoni festat? Këndoni këngë tradicionale për të.
- Tenxherja, gota apo tavolina e punës në kuzhinë tingullojnë mrekullueshëm! Lëreni fëmijën tuaj që të provojë vet krijimin e këtyre tingujve. Edhe nëse ndonjëherë është rraskapitëse për ju.



- Formoni me fëmijën tuaj instrumentet e juaja. Për shembull, mbushni kanaçet e vjetra dhe gotat me pulla apo oriz.
- Kushtojini ju me fëmijën tuaj vëmendje tingujve në jetën e përditshme. Çfarë dëgjoni në natyrë? Çfarë në rrugë? Çfarë në shtëpi?
- Dëgjoni me fëmijën tuaj muzikë të ndryshme. Për shembull, këngët e fëmijëve, muzikë pop apo muzikë klasike.
- Shkollat muzikore dhe shkollat për vallëzim ofrojnë kurse përfëmijët. Edhe në klubet sportive ka kurse vallëzimi.



10. Zbulimi i matematikës në jetën e përditshme

Matematika është kudo. Në jetën e përditshme do të gjeni numra, forma dhe përmasa. Ju mund të frymëzoni fëmijën tuaj me lojëra.

Idetë:

- Numëroni së bashku me fëmijën tuaj. Për shembull: pjesë të frutave në pjatë, goglat në tegëll ose gastaret në një kuti.
- Kërkoni me fëmijën tuaj numrat. Për shembull: numrat e shtëpive, tabelat e makinave ose etiketat e çmimeve.
- Luani lojra me letra me numra, domino dhe lojëra me zare.



- Bëni fëmijën tuaj të vetëdijshëm për kohën. Tregoni atij treguesein e madh dhe të vogël si dhe shifrat.
- Tregoni fëmijës tuaj se sa është ora. Për shembull, kur shkonit në qendrën e kujdesit ditor ose kur fëmija juaj bie për të fjetur.
- Bisedoni me fëmijën tuaj për ditët e javës. Tregoni fëmijës suaj se çfarë planifikoni të bëni në cilën ditë të javës.

- Përfshini fëmijën tuaj në kuzhinë. Lereni atë që të matë ose peshoj miell dhe sheqer me gotë matëse.



- Sfidoni fëmijën tuaj për të krahasuar gjërat.

Për shembull:

Gjeje shkopin më të gjatë.

Gjeje shtëpinë më të lartë.


Gjeje domaten më të vogël.

- Lereni fëmijën tuaj të kërkojë sendet për nga madhësia, ngjyra dhe forma.

Çfarë është e rrumbullakët?

Çfarë ka tre kënde?

Çfarë ka katër kënde?



- Luaj me fëmijën tëndë në këndin me rërë. Lereni fëmijën tuaj të derdhë apo ti mbushë me rërë ose ujë kovat e madhësive të ndryshme.

11. Eksperimentimi dhe befasimi

Fëmijët janë kureshtarë. Ata duan të zbulojnë dhe kuptojnë botën. Ju mund të ndihmoni fëmijën tuaj në këtë çështje.

Shkencën natyrore e takojmë në shtëpi dhe jashtë.

Idetë:

Në shëpi

- Mbaroni një tortë së bashku. Merrni një recetë me një brumë majë. Tregoni fëmijës tuaj majanë para pjekjes. Shikoni se çfarë ndodh me majanë në brumë.
- Vendosni ujë në një tas të madh xhami. Lëreni fëmijën tuaj të vendosë gjëra të ndryshme në ujë. Për shembull, monedha, gurë, gogla, copa druri apo kubë akulli. Shikoni me fëmijën tuaj: se çfarë noton mbi ujë? Çfarë fundoset në ujë?
- Ndërtoni një kullë të blloqeve ose kutive prej druri. Lëreni fëmijën tuaj të provojë: Si mundem ta ndërtoj një kullë të gjatë pa u shembur ajo?



- Ushtroni me fëmijën tuaj se si ti përdor pajisjet teknike. Për shembull, fshesën me korrent ose sistemin muzikor.
- A është fshesa me korrent defekt? Pastaj shikoni për arsyen së bashku me fëmijën tuaj. A është mbushur çesja e mbeturinave? A është bllokuar gypi?

Jashtë

- Bëni një dragua me fëmijën tuaj. Ngriteni së bashku në ajër. Shikoni: Se si duhet ta lëvizni draguan për të flutuar? Çfarë roli luan era?
- A ka ndonjë përrua afér jush? Ndërtoni një digë me fëmijën tuaj. Le të shikojnë se çfarë ndodh. Si mund të ndërtohet një digë e mirë? A rrjedhë ende uji përmes digës? Pse?

Në biblioteka do të gjeni libra të shumtë me lojëra dëgjimi dhe filma lidhur me temën Eksperimentimi në përditshmëri. Ka edhe programe televizive të përshtatshme, për shembull Misioni me miun (die Sendung mit der Maus), Iuleradhiqen (Löwenzahn), njojuria bën Ah! (Wissen macht Ah!), Checker Tobi.



Pse nuk mund të luash vetëm?

12. Eksplorimi dhe mbrojtja e natyrës

Ndërmerrni shetitje me fëmijën tuaj në park ose pyll. Përgjat kësaj shetitjeje mundet që fëmija i juaj ta njoftojë natyrën. Këto shetitje i ndihmojnë fëmijës tuaj të jetë i vëmendshëm ndaj kafshëve dhe mjedisit, dhe kështu që Fëmija I juaj mëson gjithnjë e më shumë për të respektuar mjedisin e tij.

Idetë:

- Në natyrë mund të zbuloni shumë. Bëni një shëtitje me fëmijën tuaj. Tregoni atij drunjët, lulet dhe kafshët.
- Bisedoni me fëmijën tuaj për stinët. Si ndryshon natyra në pranverë apo në vjeshtë?
- Zgjidhni një dru me fëmijën tuaj. Vizitonи atë dru njëherë në disa javë dhe shikoni se çka po ndërrohet në të? Çfarë ndodh me gjethet? A janë varur frutat në pemë? Si ndihet lëvorja e drurit përgjat prekjes?
- Lejoni fëmijën tuaj të marrë përgjegjësinë. Ai mundet në shtëpi që të marr përgjegjësinë për një bimë.
- Dalloni me fëmijën tuaj bimët ushqimore dhe jo të ngrënshme. Për shembull, mbillni një erëz (*lepidium sativum*). Shikoni me fëmijën tuaj se si rritet kjo erëz. Më vonë ju mundeni ta korrni këtë erëz, dhe ta shijoni, për shembull, në supë apo edhe në bukë.
- Gjatë një shetitjeje në kopshtin zoologjik, fëmija juaj mund të mësojë, shumë kafshë të ndryshme, ti ushqejë sidhe ledhatojë.

- Tregoni fëmijës tuaj se prej nga vijnë qumështi dhe vezët. Vizitoni së bashku një fermë ose një kullotë të lopëve.
- Bëni me fëmijën tuaj një veprim të kujdeshëm me natyrën. Tregoni atijë se si mund të shmangë mbeturinat. Për shembull, merrni një qese me vete.
- Shpjegoni atij se nuk bën që të hidhen mbeturinat në natyrë. Mbeturinat futen në kosh.
- Ju gjithashtu mund të praktikoni mbrojtjen e mjedisit edhe në shtëpi. Për shembull: Diskutoni me fëmijën tuaj: Cilat mbeturina futet në cilin kosh? Shpjegoni atij se nuk ka një sasi të pafundme uji. Ndaleni ujin derisa i pastroni dhëmbët.



13. Trajtimi i mjeteve të komunikimit

Fëmijët rriten sot në prezencën e shumë mjeteve të komunikimit. Për shembull, kompjuter, smartphone dhe tabletë. Atyre u pëlqen ajo se çka mundë të bëhet me të. Shoqëroni fëmijën tuaj kur ai i përdor këtë media. TV dhe smartphone duhet që të zëvendësohen ndënjosherë me lojëra dhe lëvizje të tjera.

Idetë:

- Në moshën parashkollore, fëmijët duan të shohin filma të shkurtër në televizion. Zgjidh një film të shkurtër me fëmijën tuaj. Për shembull ju mund të përdorni www.flimmo.de. Kushtojini vëmendje asaj se për cilën moshë është i lejuar filmi. Ky informacion është shpesh i vendosur pas shkurtesës „FSK“.
- Shikoni filmin me fëmijën tuaj së bashku. Bisedoni me të rreth përbajtjes. A dëshironë fëmija juaj të vizatojë një fotografi të filmit? Pergjatë kësaj ai mundet të përpunojë përbajtjen.
- Përcaktoni se sa kohë ka të drejtë fëmija juaj të përdorë mediat. Ju mundeni që ta percaktoni kohen së bashku me një mbatës kohe. Gjatë ditës, fëmija juaj nuk do të duhej të shikonte televizor më shumë se 30 minuta.
- Lojëra për dëgjim, libra për dëgjim sidhe këngë për fëmijë munden që të dëgjohen edhe vetëm, pra pa prezencën tuaj. Mirëpo ju duhet që të jeni diku aty afër. Duhet ta dini se çfarë po dëgjon fëmija juaj. Ju keni mundesinë që ti huazoni këto lojëra për dëgjim në bibliotekë.
- Nëse fëmija juaj ka një pyetje? Atëherë kérkonit përgjigjjen së bashku me të. Kérkimin tuaj mundeni ta ndihmini me një faqe kërkuese interneti. P.sh. www.fragfinn.de.



- Fëmija juaj mund të luajë lojëra në një konzolë ose smartphone. Përgjatë kësaj kohe fikeni Internetin nga këto pajisje. Sigurohuni që këto lojëra të janë të përshtatshme për grupmoshën e fëmijës suaj. Qëndroni me fëmijën tuaj. Përfundojeni lojën nëse fëmija i juaj përgjatë lojës shqetësohet.
- Lereni fëmijën tuaj të fotografojë dhe filmojë vet. Fëmija juaj më vonë mund t'i tregojë se çka ka ndjerë përgjat atyre fotove. Pra, kështu kujtimet mbisin të paharruara.

Këto këshilla mund të lexohen më detajisht në internet:

www.schau-hin.info

Këshilla të tjera mundë të gjeni përshembull nën:

www.klick-tipps.net

www.klicksafe.de

Faqet e kërkimit për fëmijët janë:

www.blinde-kuh.de

www.fragfinn.de

Rreth temës së televizionit:

www.kinderfilmwelt.de

www.flimmo.de

www.tivi.de

www.checkeins.de

www.kika.de



Të drejtat e autorit

Ballina:

Faqja frontale: © Zeichnung von Lisa Eckhardt, inspiriert (Figuren) durch Angela-Maria Meyer,
MN-Consultants

Faqja e pasme: © Lisa Eckhardt

Përmbytja:

Foto e vetme: © Lisa Eckhardt

Faqja 2: © panthermedia.net / Monkeybusiness Images

Faqja 3: © panthermedia.net / anatols

Faqja 4: © Veit Mette

Faqja 5: © panthermedia.net/StockbrokerXtra by Monkeybusiness
© private

Faqja 6: © panthermedia.net / StephanieFrey

© panthermedia.net / JCB Prod

Faqja 7: © panthermedia.net / luninastock

Faqja 8: © unsplash.com/ charleingracia

Faqja 9: © panthermedia.net / Robert Byron

Faqja 10: © panthermedia.net / Monkeybusiness Images

Faqja 11: © panthermedia.net / creatista

Faqja 12: © panthermedia.net / didesign

Faqja 13: © panthermedia.net / londondeposit

Faqja 15: © Lisa Eckhardt

Faqja 16: © Veit Mette

Faqja 17: © panthermedia.net / Craig Robinson

Faqja 18: © panthermedia.net / Katy Spichal

Faqja 19: © panthermedia.net / Wolfgang Steiner

© panthermedia.net / choreograph

Faqja 20: © panthermedia.net / natochka

© panthermedia.net / pathastings

Faqja 21: © panthermedia.net / BestPhotoStudio

Faqja 23: © panthermedia.net / Xalanx

Faqja 25: © panthermedia.net / Wong Sze Fei

Faqja 26: © panthermedia.net / Mitar gavric

Shënimë

